

REGJISTRAT E BIZNESIT

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	6
5. Periudha e referencës	6
6. Mandati institucional	6
7. Konfidencialiteti	7
8. Politika e botimit.....	8
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	8
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	8
11. Manaxhimi i cilësisë	10
12. Rëndësia.....	10
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	11
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	11
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	12
16. Kostoja dhe ngarkesa	13
17. Rishikimi i të dhënave	13
18. Përpunimi statistikor.....	13
19. Komente.....	15
Aneks	15

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Flutura Sala
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës sektori
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	frama@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	01.06.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	01.06.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	01.06.2023
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Regjistrat e biznesit (RB) janë korniza bazë për mbledhjen dhe përpilimin e të dhënave për statistikat evropiane të biznesit. RB përdoren si burimi kryesor i informacionit për analizën statistikore të popullatës së biznesit dhe demografinë e saj, për përcaktimin e popullsisë së anketuar dhe për vendosjen e lidhjes me burimet e të dhënave administrative.</p> <p>RB duhet të bëhen një burim autoritar për nxjerrjen e popullsisë kornize të harmonizuara për prodhimin e statistikave të biznesit evropian. RSB-të kontribuojnë në prodhimin e statistikave të qëndrueshme dhe të krahasueshme të biznesit duke krijuar dhe përdorur popullata të koordinuara të njëjësive statistikore.</p>

	<p>RB kombëtar përfshijnë informacione për popullsinë e biznesit (më të përditësuara për popullsinë aktive):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësitë ligjore nga të cilat përbëhen këto ndërmarrje (bizneset e regjistruar në zyrat e taksave); • të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari ekonomike që kontribuojnë në prodhimin e brendshëm bruto (PBB) dhe njësitë e tyre vendore; • Grupet e ndërmarrjeve të cilave u përkasin ato ndërmarrje. <p>Variablat kryesorë të regjistruar në regjistrat statistikore të bizneseve janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Variablat e identifikimit: numri i identifikimit, emri, adresa; • Ngjarjet demografike: data e fillimit/ndërprerjes së njësisë; • Variablat ekonomike/parametrat e shtresëzimit: aktiviteti ekonomik (NACE Rev.2), punësimi gjithsej, të punësuarit me pagesë, xhiro, forma ligjore, statusi i aktivitetit ligjor; • Informacion mbi kontrollin dhe pronësinë e bizneseve; • lidhjet me njësitë dhe regjistrat e tjerë.
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Sistemet e klasifikimit dhe listat e kodeve të përdorura RB janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian në nivel 4 shifror, Nomenklatura e veprimtarive ekonomike (NVE Rev. 2); • Sektorët dhe nënsektorët institucionalë (ESA 2010); • Nomenklatura e Njësive territoriale për Statistika (NUTS II); • Forma ligjore (bazuar në ligjin kombëtar); • Lista e kodeve të pronësisë; • Emri dhe kodi i shtetit (GEONOM 2021); • Madhësia e ndërmarrjeve (bazuar në numrin e të punësuarve gjithsej).
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Mbulimi i RB është përcaktuar në Rregulloren (BE) 2019/2152 për statistikat evropiane të biznesit. RB përfshijnë të gjitha ndërmarrjet rezidente në territorin e Shqipërisë dhe aktivitetet ekonomike të tyre kontribuojnë në PBB.</p> <p>Familjet nuk përfshihen në kuadër të kornizës evropiane për regjistrat statistikore të biznesit për aq sa mallrat dhe shërbimet që ato prodhojnë janë të destinuara për konsumin e tyre.</p> <p>RB mbulojnë të gjitha njësitë që, tërësisht ose pjesërisht, ushtrojnë një aktivitet ekonomik dhe njësitë juridike ekonomikisht joaktive, të cilat janë pjesë e një ndërmarrje në kombinim me njësitë juridike ekonomikisht aktive.</p> <p>Për qëllimet e kornizës evropiane për regjistrat statistikore të bizneseve, konsiderohen aktivitetet ekonomik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • çdo aktivitet që përfshin ofertën e mallrave dhe shërbimeve në një treg të caktuar; • Shërbimet jo-tregtare që kontribuojnë në PBB; • zotërimet direkte dhe indirekte të njësive ligjore aktive.

	<p>Regjistri kombëtar statistikor i biznesit përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të gjithë sektorët ekonomikë të bazuar në NVE Rev.2 (A-U)
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Konceptet dhe përkufizimet kryesore statistikore të përdorura për regjistrat statistikorë të biznesit janë si më poshtë:</p> <p>Kopje vjetore e RB Kopja vjetore e RB pasqyron gjendjen e biznesit në fund të vitit (referencë) duke përfshirë të gjitha njësitë. Institucionet kombëtare të statistikave duhet të bëjnë një kopje çdo vit dhe ta ruajnë atë për të paktën 10 vjet për qëllime analize.</p> <p>Njësi aktive Një njësi statistikore konsiderohet se ka qenë aktive gjatë periudhës së referencës, nëse në këtë periudhë ose ka realizuar xhiro neto pozitive ose ka prodhuar ose ka të punësuar ose ka kryer investime.</p> <p>Një njësi juridike mund të jetë juridikisht ose administrativisht aktive pa asnjë aktivitet ekonomik, kur njësia juridike joaktive është pjesë e një sipërmarrjeje në kombinim me njësi juridike ekonomikisht aktive. Mbajtja e aktiveve dhe/ose detyrimeve do të konsiderohet gjithashtu si një aktivitet ekonomik.</p> <p>Numri i ndërmarrjeve aktive Numri i ndërmarrjeve aktive është numri i të gjitha njësive statistikore të cilat në çdo kohë gjatë periudhës së referencës kanë qenë "ndërmarrje", siç përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 696/93, dhe gjithashtu aktive gjatë së njëjtës periudhë referimi. Një njësi statistikore konsiderohet se ka qenë aktive gjatë periudhës së referencës, nëse në këtë periudhë ose ka realizuar xhiro neto pozitive ose ka prodhuar ose ka të punësuar ose ka kryer investime.</p> <p>Numri i të punësuarve Numri i të punësuarve përfaqëson numrin mesatar të personave që në një kohë gjatë periudhës referenë kanë qenë punonjës të njësisë statistikore.</p> <p>Numri i të punësuarve dhe të vetëpunësuarve Numri i të punësuarve dhe të vetëpunësuarve është shuma e numrit të të punësuarve dhe numrit të personave të vetëpunësuar. Numri i personave të vetëpunësuar është numri mesatar i personave që në një kohë gjatë periudhës së referencës kanë qenë pronarë të vetëm ose bashkëpronarë të njësisë statistikore në të cilën ata punojnë. Përfshihen gjithashtu punonjësit e familjes dhe punonjësit jashtë, të ardhurat e të cilëve janë në funksion të vlerës së prodhimit të njësisë statistikore.</p> <p>Numri i njësive lokale Një numërim i numrit të njësive lokale siç përcaktohet në Rregulloren (EEC) Nr. 696/93 të regjistruara për popullsinë në fjalë në regjistrat e biznesit, korrigjuar për gabime, në veçanti gabime kornizë. Njësitë lokale duhet të përfshihen edhe nëse nuk kanë punonjës me pagesë. Kjo statistikë duhet të përfshijë të gjitha njësitë aktive gjatë të paktën një pjese të periudhës referuese.</p> <p>Aktiviteti kryesor Aktiviteti kryesor është aktiviteti që kontribuon më shumë në vlerën totale të shtuar të një njësie në shqyrtim. Në mënyrë ideale, aktiviteti kryesor i njësisë duhet të përcaktohet duke iu referuar vlerës së shtuar të mallrave</p>

	<p>dhe shërbimeve të prodhuara, duke aplikuar metodën nga lart-poshtë (top-down method). Metoda nga lart-poshtë ndjek një parim hierarkik: klasifikimi i njësisë në nivelin më të ulët të klasifikimit duhet të jetë në përputhje me klasifikimin e njësisë në nivele më të larta. Aktiviteti kryesor i identifikuar kështu nuk përbën domosdoshmërisht 50% ose më shumë të vlerës së shtuar totale të njësisë.</p> <p>Në Bashkimin Evropian, klasifikimi i aktivitetit kryesor përcaktohet duke iu referuar NACE Rev. 2, fillimisht në nivelin më të lartë të klasifikimit dhe më</p> <p>Aktiviteti dytësor Një aktivitet dytësor është çdo aktivitet i veçantë që prodhon produkte përfundimisht për palët e treta dhe që nuk është aktiviteti kryesor. Produktet e aktiviteteteve dytësore janë produkte dytësore.</p> <p>Xhiro vjetore Xhiro vjetore përfshin shumën totale të faturuar nga ndërmarrjet gjatë periudhës së referencës, dhe kjo korrespondon me shitjet në treg të mallrave ose shërbimeve të ofruara palëve të treta.</p> <p>Fermerët Fermerët e regjistruar gjatë viteve të fundit identifikohen me kod unik (NIPT) dhe zbatojnë skemën specifike të kompensimit për qëllime të prodhuesve bujqësorë të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Procesi i regjistrimit në zyrat e tatimeve i mundëson fermerëve të kenë personalitet juridik dhe të jenë pjesë e RB që përditëson dhe mban INSTAT.</p> <p>Më shumë informacion mbi konceptet dhe përkufizimet statistikore që lidhen me RB mund të gjenden në manualin metodologjik të EBS për Regjistrat Statistikore të Bizneseve (botimi 2021).</p>
<p>3.5. Njësia statistikore</p>	<p>Njësitë statistikore të mbajtura në RB përcaktohen në përputhje me Rregulloren Nr. 696/93 për njësitë statistikore për vëzhgimin dhe analizën e sistemit të prodhimit në Komunitet, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmarrja - ndërmarrja është kombinimi më i vogël i njësive ligjore që është një njësi organizative që prodhon mallra ose shërbime, e cila përfiton një shkallë të caktuar autonomie në vendimmarrje, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve të saj aktuale. Një ndërmarrje kryen një ose më shumë aktivitete në një ose më shumë lokacione. Një ndërmarrje mund të jetë një njësi e vetme ligjore. • Grupi i ndërmarrjeve - një grup ndërmarrjesh është një shoqatë e ndërmarrjeve të lidhura së bashku me lidhje ligjore dhe/ose financiare. Një grup ndërmarrjesh mund të ketë më shumë se një qendër vendimmarrëse, veçanërisht për politikën mbi prodhimin, shitjet dhe fitimet. Ai mund të centralizojë disa aspekte të menaxhimit financiar dhe taksave. Ai përbën një subjekt ekonomik, i cili është i autorizuar të bëjë zgjedhje, veçanërisht në lidhje me njësitë që ai përbëhet. • Njësia lokale - njësia lokale është një ndërmarrje ose pjesë e saj (p.sh. një punishte, fabrikë, magazinë, zyrë, minierë ose depo) e vendosur në një vend të identifikuar gjeografikisht. Në këtë vend ushtrohet veprimtari ekonomike për të cilën – (me përjashtim të disa përjashtimeve) - punojnë një ose më shumë persona (qoftë edhe me kohë të pjesshme) për të njëjtën ndërmarrje.

3.6. Popullata statistikore	<p>RB do të jenë burimi kryesor për nxjerrjen e një popullate të regjistrit statistikor të biznesit me cilësi të lartë dhe të harmonizuar për prodhimin e statistikave evropiane në përputhje me nenin 8 të Rregullores e Statistikave Evropiane të Biznesit 2019/2152.</p> <p>Regjistrat e biznesit përbëhen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësitë ligjore; • Ndërmarrjet; • Njësitë Lokale; • Grupet e Ndërmarrjeve.
3.7. Zona e referencës	<p>Zona e referencës për RB është territori i vendit. Përsa i përket grupeve të ndërmarrjeve, çdo vend jashtë territorit kombëtar mund të jetë i rëndësishëm.</p>
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Regjistri kombëtar statistikor i biznesit është krijuar në vitin 1998.</p> <p>Njësitë statistikore zbatohen dhe mbahen në RB si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmarrja – zbatohet dhe mirëmbahet që nga viti 1998 • Njësia Lokale– zbatohet dhe mirëmbahet që nga viti 2010. • Grupi i Ndërmarrjeve – zbatohet dhe mirëmbahet që nga viti 2017 • Lloji i aktivitetit të njësisë (KAU)– faza e testimit (RB 2021)
3.9. Periudha bazë	<p>Nuk aplikohet.</p>
4. Njësia matëse	<p>Variablat ekonomike të punësimit mbahen në vlerë absolute. Xhiro vjetore mbahen në njësinë valutore, lekë.</p>
5. Periudha e referencës	<p>Periudha e referencës për kopjen vjetore të RB është një vit kalendarik.</p> <p>Një kopje vjetore që pasqyron gjendjen e bizneseve në fund të vitit mbahet për të paktën 30 vjet për qëllime analize.</p> <p>Kopja më e fundit e disponueshme e RB është ajo viti 2022.</p> <p>Në këtë kopje vjetore, variablat ekonomike (numri i punonjësve gjithsej, xhiro vjetore dhe aktiviteti ekonomik) i referohen fundit të vitit referencë 2022.</p>
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Aktet juridike dhe marrëveshjet e tjera – në nivelin e BE-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja (BE) 2019/2152 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 nëntor 2019 mbi statistikave evropiane të biznesit; • Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/1197 e datës 30 korrik 2020 që përcakton specifikimet teknike dhe aranzhimet në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/2152 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi statistikave evropiane të biznesit.

	<p>Aktet juridike dhe marrëveshjet tjera - nivel kombëtar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligj nr. 17/2018 datë 5.4.2018 “Për statistikat zyrtare”; • Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) 2019/2152 e datës 27 nëntor 2019, mbi “Statistikat Evropiane të Biznesit”; • Ligji nr. 30/2022 datë 24.03.2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”; • Vendim i Këshillit të Ministrave për “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të revizionuar (Rev. 2)” Nr. 320 datë 28.5.2014; • Ligji nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale Të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën E Shqipërisë” • Ligji nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”; • Ligj nr. 43/2022 datë 21.04.2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”; • Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 15.12.2010. “Për zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (Tri) Rajone NUTS II”, sipas nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat (NUTS) 1 , të Bashkimit Evropian; • Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe INSTAT, datë 11.3.2015; • Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe INSTAT, datë 13.6.2017; • Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 19 datë 3.11.2014” Për Zbatimin e Regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”. • Vendimi i KM, Nr. 541, datë 29.9.2021 "Për miratimin e nomenklaturës së shteteve dhe të territoreve për statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave dhe ndarjen gjeografike për statistikat e tjera të biznesit”
<p>6.2. Shkëmbimi i të dhënave</p>	<p>Rregullorja e Statistikave Ekonomike Evropiane të Biznesit (BE) 2019/2152 EBS Regulation (EU) 2019/2152 parashtron dispozita për shkëmbimin dhe aksesin në të dhëna konfidenciale për qëllimin e kornizës evropiane për regjistrat statistikorë të biznesit.</p> <p>Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2020/1197 përcakton specifikimet teknike dhe aranzhimet në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/2152, duke përfshirë specifikimet teknike për shkëmbimin e të dhënave konfidenciale për qëllimet e kornizës evropiane për regjistrat statistikorë të biznesit.</p> <p>Në nivel kombëtar, janë vendosur marrëveshjet ose procedurat e mëposhtme për ndarjen dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet autoriteteve kombëtare.</p>
<p>7. Konfidencialiteti</p>	
<p>7.1. Konfidencialiteti - politika</p>	<p>Rregullorja (KE) Nr. 223/2009 (paragrafi 24 dhe neni 20(4)) e datës 11 mars 2009 (OJ L 87, f. 164) mbi statistikat evropiane përcakton nevojën për të vendosur parime dhe udhëzime të përbashkëta që garantojnë</p>

	<p>konfidencialitetin e të dhënave të përdorura për prodhimin e statistikave evropiane dhe aksesin në ato të dhëna konfidenciale duke marrë parasysh zhvillimet teknike dhe kërkesat e përdoruesve në një shoqëri demokratike.</p> <p>Rregullat e mëposhtme të politikave zbatohen në nivel kombëtar:</p> <p>Aksesi në mikrodata Instat</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Sipas rregullave të politikave (shih seksionin 7.1).
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	<p>Të dhënat paraprake të RB lëshohen sipas nevojave statistikore të përdoruesve si kornizë kampionimi për qëllimet e metodologjive. Mostra dhe periudha kryesore janë renditur më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • T+ 1.5 muaj në sektorin e statistikave tremujore; • T+ 1.5 muaj në sektorin e statistikave strukturore; • T+ 1.5 muaj për anketën e TIK; • T+ 1.5 muaj për anketën e R&D; • T+ 3 muaj deri në (fusha të tjera). <p>RB finalizohen (frozen file) në T+ 3 muaj.</p>
8.2. Aksesi në kalendarin e publikimeve	Nuk aplikohet.
8.3. Aksesi i përdoruesve	<p>Përdoruesit e statistikave kanë akses në statistikat zyrtare të RB ose marrin të dhënat e kërkuara në mënyrën e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrat e biznesit (publikimet vjetore); • Baza e të dhënave PxWeb - Zgjidh tabelën (instat.gov.al) • Kërkesa për statistika me letër ose me email në info@instat.gov.al
9. Shpeshësia e shpërndarjes	<p>Të dhënat paraprake të RB (draft file) u ofrohen përdoruesve të brendshëm me frekuencë T+1.5 muaj.</p> <p>RB përfundimtarë u ofrohen përdoruesve të brendshëm me frekuencë T+ 4 muaj.</p> <p>Të dhënat e RB nuk përfshijnë publikimin e rezultateve paraprake.</p> <p>Rezultatet e publikimit të RB publikohen sipas kalendarit:</p> <p>Kalendari Instat</p>
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Nuk aplikohet
10.2. Publikime	Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet e RB në publikimet më poshtë:

	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrat e biznesit; • Vjetari Rajonal Statistikor; • Vjetari Statistikor; • Burra dhe Gra; • Ndërmarrjet e Huaja në Shqipëri
10.3. Baza e të dhënave on-line	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrat e biznesit Databaza
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	<p>Rregullorja (KE) Nr. 223/2009 (paragrafi 24 dhe neni 20(4)) e datës 11 mars 2009 (OJ L 87, f. 164) mbi statistikat evropiane përcakton nevojën për të vendosur parime dhe udhëzime të përbashkëta që garantojnë konfidencialitetin e të dhënave të përdorura për prodhimin e statistikave evropiane dhe aksesin në ato të dhëna konfidenciale duke marrë parasysh zhvillimet teknike dhe kërkesat e përdoruesve në një shoqëri demokratike.</p> <p>INSTAT siguron të dhëna mikro për qëllime kërkimore shkencore. Aksesit në këto të dhëna kontrollohet rreptësisht dhe sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 17, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare”.</p> <p>Rregullore e Aksesit në të Dhënat Mikro Aksesit në Mikrodata</p>
10.5. Të tjera	<p>I gjithë informacioni është i disponueshëm në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seri kohore e RB nga viti 2010 si vit referencë. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik</p> <p>Hyni në bazën e të dhënave në lidhjen më poshtë: Baza e të dhënave</p>
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Manuali metodologjik i statistikave evropiane të biznesit për RB– versioni 2021, përshkruan metodologjinë që do të përdoret për Institutet Kombëtare të Statistikave.</p> <p>Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në publikim. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme.</p> <p>Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi regjistrin statistikor.</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	<p>Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e RB për qëllime të brendshme.</p> <p>Grupi i përdoruesve të RB u krijua në vitin 2015 dhe drejtohet nga Drejtori i Statistikave Ekonomike. Grupi i përdoruesve të RB përbëhet nga përgjegjësit e sektorëve kryesor të cilët janë përdorues të RB. Qëllimi kryesor i grupit të përdoruesve të RB është rritja e cilësisë së tyre si mjeti kryesor për statistikat e biznesit dhe makro-ekonomike.</p> <p>Sektori i SRSN propozon që të përgatitet lista e ndërmarrjeve të mëdha dhe të trajtohen më me kujdes. Kjo erdhi si rezultat i NVE Rev.2 (4-digit) të</p>

	ndryshme nga anketa të ndryshme. NVE rev.2 për secilën ndërmarrje në listë është fiksuar dhe miratuar nga Grupi i Përdoruesve të RB.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistika Zyrtare, Nr.17/2018, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara.</p> <p>Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e RB krahasohen me të dhënat e regjistrave në vitet e mëparshme për të dalluar nëse ka koherence të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative/vrojtimit statistikore për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e RB ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Bizneset • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>Botimi RB i dërgohet çdo vit në një grup të caktuar përdoruesish. Gjithashtu plotësohen pyetësorë të dedikuar nga institucionet ndërkombëtare si Eurostat, Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian dhe Banka Botërore. Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin të dhënat e RB si input në punën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektorët nga Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Sektori i Metodologjisë • Sektori i Indekseve (veçanërisht për përditësimin e skedarit të TVSH-së me klasifikimin NACE) • Drejtoria e Statistikave Rajonale • Drejtoria e Statistikave Sociale • Zyrat Rajonale të Statistikave

12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p> <p>Klikimet (Page Views) në lidhje me RB për vitin 2022 janë rreth 5,931 klikime.</p> <p>Gjate 2022 ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e statistikave të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve është vlerësuar me 3.35 (67.0%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p>				
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria dhe cilësia e RB vlerësohet çdo vit nga Eurostat. Rezultatet e vlerësimit të RB u për Shteteve Anëtare të BE-së, vendeve të EFTA-s dhe vendet candidate prezantohen në Grupin e Punës së Regjistrave Statistikor të Biznesit (SBR WG).</p> <p>Variablat kryesorë të regjistruar në RB janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Variablat e identifikimit: numri i identifikimit, emri, adresa; • Ngjarjet demografike: data e fillimit/ndërprerjes së njësisë; • Variablat ekonomike/parametrat e shtresëzimit: aktiviteti ekonomik (NACE Rev.2), punësimi gjithsej, të punësuarit me pagesë, xhiro, forma ligjore, statusi i aktivitetit ligjor; • Informacion mbi kontrollin dhe pronësinë e bizneseve; • Lidhjet me njësitë dhe regjistrat e tjerë; • Të tjera. 				
13. Saktësia dhe besueshmëria					
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Të dhënat e vitit referencë krahasohen me të dhënat e viteve më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.</p>				
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.				
13.3. Gabim jo i kampionimit	Nuk aplikohet.				
14. Afatet kohore dhe përpikmëria					
14.1. Afatet kohore	<p>Të dhënat paraprake janë të disponueshme T+1.5 pas vitit referencë. Dataset final është i disponueshëm T+3 pas vitit reference.</p> <p>Të dhënat e RB publikohen 5 muaj pas përfundimit të vitit referencë (T+ 150 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Regjistrave të biznesit 2022 është 31 Dhjetori 2022.</p> <table border="1" data-bbox="549 1935 983 2045"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/1/2023</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	6/1/2023
Periudha referuese	12/31/2022				
Data e publikimit	6/1/2023				

	Afatet kohore	150								
14.2. Përpikmëria	<p>Publikimi vjetor i RB kanë qenë i përpiktë në kohë (100 %) të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>6/1/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/1/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>		Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	6/1/2023	Data e publikimit	6/1/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022									
Data e shpallur	6/1/2023									
Data e publikimit	6/1/2023									
Vonesa në kohë	0									
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria										
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Krahasueshmëria gjeografike e RB është në përputhje me zbatimin e përkufizimeve të përbashkëta të njësive statistikore të përcaktuara në Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 696/93.</p> <p>Variablat RB janë harmonizuar dhe vendosur në përputhje me Aneksin VIII të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/1197 që përcakton specifikimet teknike dhe aranzhimet në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/2152 mbi statistikën evropiane të biznesit. Udhëzime të mëtejshme për zbatimin e variablave në regjistrat statistikore kombëtarë të bizneseve jepen në manualin metodologjik EBS për Regjistrat Statistikore të Bizneseve (botimi 2021).</p>									
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Krahasueshmëria në kohë e dateseteve rezulton nga informacioni i dhënë në konceptin 3.8.</p> <p>RB janë të krahasueshme për vitet referuese 2010 deri në 2022.</p> <p>NVE Rev.2 dhe Ndarja Administrativo-Territoriale e Republikës së Shqipërisë në 61 bashki zbatohet që nga viti 2005.</p>									
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Korniza e RB ofron informacion mbi popullsinë aktive të ndërmarrjeve që kryejnë aktivitete ekonomike të cilat kontribuojnë në produktin e brendshëm bruto (PBB), njësitë ligjore nga të cilat përbëhen këto ndërmarrje, njësitë ligjore dhe grupet e ndërmarrjeve, përfshirë grupet e sipërmarrjeve rezidente dhe shumëkombëshe.</p> <p>RB përdoren nga përdoruesit statistikore si një grup i koordinuar kornizë me qëllim të nxjerrjes së rezultateve të qëndrueshme statistikore.</p>									
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.</p>									

<p>16. Kostoja dhe ngarkesa</p>	<p>Për procesin e imputimit RB përdor të dhënat administrative dhe nuk ka kosto shtesë për trajtimin e mos përgjigjes. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis</p> <p>INSTAT dhe DPT apo QKB konfirmojnë që të dhënat transmetohen pa kosto. Të dhënat statistikore gjithashtu janë pa kosto për RB. Staf i RSN bën kontrollin dhe përpunimin e të dhënave për rezultatin final.</p>
<p>17. Rishikimi i të dhënave</p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit të RSN bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Nuk aplikohen.</p>
<p>18. Përpunimi statistikor</p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>RB janë krijuar në përputhje me Rregulloren EBS (BE) 2019/2152 duke përdorur çdo burim të rëndësishëm të të dhënave, duke shmangur barrën e tepërt për të anketuarit dhe duke marrë parasysh efektivitetin e koston së Instituteve kombëtare të Statistikave.</p> <p>RB me vit referencë 2022 përditësohen nga:</p> <p>Burime administrative</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacioni nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); • Informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT); • Skedari i TVSH-së; • Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve. <p>Burime statistikore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, ASN; • Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve, ATN; • Anketa Strukturat Akomoduese, ASA; • Anketa të tjera.
<p>18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>RB-të do të përditësohen me frekuence vjetore me anë të hyrjeve dhe largimeve (bizneseve). Frekuenca e përditësimit do të varet nga lloji i njësisë ligjore, variabli, madhësia e njësisë dhe burimi i përdorur përgjithësisht për përditësimin.</p> <p>Frekuenca e përditësimit të njësisve dhe variablave në RB është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njesitë ligjore – mujore; • Ndërmarrjet – mujore; • Njesitë lokale - vjetore.

18.3. Grumbullimi i të dhënave	RB përdorin të dhëna nga burime të të dhënave administrative dhe vrojtme statistikore, dhe nga çdo burim tjetër përkatës që janë të krahasueshme dhe në përputhje me kërkesat specifike të cilësisë në fuqi. Për më shumë detaje, ju lutemi shihni 18.1.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e editimit të të dhënave në përgjithësi i referohen editimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel ndërmarrje apo njësi lokale. Kontrollat e kryera bazohen kryesisht në përputhshmërinë me klasifikimet evropiane dhe kombëtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • NVE Rev.2; • Forma ligjore; • Pronësia Shtetet; • Bashkia; • Qarku. <p>Kontrolle manuale bëhen për ndërmarrjet e mëdha dhe për ndërmarrjet në degë strategjike si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Transporti hekurudhor; • Transporti ajror; • Aktivitete postare dhe të korierës; • Prodhimi i energjisë elektrike; • Administrata publike. • Të tjera. <p>Aktiviteti ekonomik i tyre është miratuar nga grupi i përdoruesve të RB, i cili merr në shqyrtim dhe vendos në rastet e paraqitjes së ndryshimit të aktivitetit ekonomik për çdo njësi statistikore.</p>
18.5. Përpilimi i të dhënave	Krijimi i njësive ligjore të reja automatikisht çon në krijimin e një ndërmarrjeje dhe një njësie lokale të re me variablat e RB. Ky informacion sikurse dhe ndryshimet përftohen nga burimi administrativ, kryesisht DPT. Informacioni në nivel ndërmarrje përditësohet nga vrojtmet e ndryshme sipas listës së prioriteteve dhe periudhës referencë të burimit administrativ apo statistikor. Për ndërmarrjet e mëdha bëhen përditësime manuale edhe nga kërkimet në internet. Vetëm sektori i RSN ka të drejtë të bëjë ndryshime. Sektorët e tjerë të INSTAT dërgojnë të dhënat në nivel ndërmarrje nga vrojtmet apo ndryshime të tjera.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.

<p>19. Komete</p>	<p>Qeveria shqiptare në vitin 2015 vendosi që fermerët të regjistrohen në zyrat e taksave dhe të përfitojnë nga skema specifike e kompensimit për qëllime të prodhuesve bujqësorë të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.</p> <p>Rrjedhimisht, procesi i regjistrimit, i mundësoi fermerëve të kenë personalitet juridik dhe të jenë pjesë e njësisë ligjore në BR.</p> <p>Në fund të vitit 2022, fermerët zënë 40,3 ndaj totalit të njësive ligjore aktive.</p> <p>Spektori i RSN me mbështetjen e Eurostat, për herë të parë identifikoi njësinë statistikore KAU-në në RB 2019. KAU po zbatohet gjithashtu në RB 2020-2021.</p>
<p>Aneks</p>	